



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 340/prot.
4

Tiranë, më 05.12.2023

VENDIM

Nr. 1035, Datë 05.12.2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË VOLVO BUSINESS SERVICES INTERNATIONAL AB DHE RENAULT S.A.S”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua njoftimi në lidhje me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Volvo Business Services

International AB dhe Renault s.a.s.

Referuar “Marrëveshjes Kuadër në lidhje me FlexEco” dhe Shtojcës “Marrëveshje për Sipërmarrjen e përbashkët”, të nënshkruar më datë 05 tetor 2023, palët në transaksion janë:

Pala 1: Volvo Business Services International AB është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë. Volvo Business Services International AB është një shoqëri holding, e cila nuk kryen aktivitet tregtar dhe kontrollohet plotësisht nga AB Volvo.

AB Volvo është një shoqëri multinacionale, aktive në prodhimin dhe shitjen e kamionëve për asfalt apo terren të pashtuar, autobusëve, makinerive të ndërtimit, motorëve për mjete detare, motorëve industrialë për makineri për lëvizje në terren të pashtuar dhe gjeneratorë, si dhe motorëve për automjete për rrugë të asfaltuara.

Njësitë kryesore të biznesit të saj përfshijnë:

- **Produktet:** zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i kamionëve, autobusëve, motorëve të makinave dhe makinerive të ndërtimit; dhe
- **Shërbimet:** shërbime financimi për klientët.

Grupi Volvo nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri, por gjeneron xhiro nëpërmjet shitjeve të realizuara.

Pala 2: Renault s.a.s është një shoqëri aksionare e thjeshtuar, e themeluar sipas legjislacionit francez, me objekt aktiviteti: prodhimi, tregtimi i automjeteve, të gjitha shërbimet e lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet shoqërive të tjera, administrimi i titujve (tituj pjesëmarrje dhe vendosjeje) dhe çdo veprimtari financiare, imobiliare apo tregtare lidhur me to.

Renault s.a.s kontrollohet 100% nga Renault S.A., pjesë e Grupit Renault.

Biznesi i Grupit Renault ndahet në dy sektorë operacionalë:

- **Produktet:** projektimi, prodhimi dhe shpërndarja e automjeteve për pasagjerë, pick-up dhe LCV (light commercial vehicles) nëpërmjet një rrjeti shitjesh për: (i) automjete të reja të madhësive të ndryshme nën tre markat: “Renault”, “Dacia”, dhe “Alpine”; (ii) automjete të përdorura dhe pjesë këmbimi; (iii) kategorinë powerange të Renault (tregtohet vetëm për bizneset).
- **Shërbimet:** financime shitjesh, dhënie me qira, kontrata mirëmbajtjeje dhe shërbimesh. Pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve ofrohen nga Mobilize Financial Services, një shoqëri e kontrolluar plotësisht që ofron shërbime financiare për Grupin Renault në 36 vende.

Grupi Renault nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri, por gjeneron xhiro nëpërmjet shitjeve të realizuara.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV), FlexEco SAS është një shoqëri aksionare e thjeshtuar, e themeluar sipas legjislacionit francez, me aktivitet kryesor: zotërimi dhe menaxhimi i pjesëmarrjes në shoqëri të tjera që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e automobilistikës ose në fusha të tjera.

FlexEco SAS synon të prodhojë një set automjetesh elektrike me bateri, të identifikuar si FlexE dhe t'u ofrojë aktorëve të logjistikës një zgjidhje gjithëpërfshirëse për produktet e logjistikës urbane. Ajo do të fokusohet fillimisht në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e FlexE10, një LCV i mesëm.

FlexEco SAS nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmarrja e Përbashkët është themeluar në Francë nga shoqëria Renault s.a.s, më datë 05 mars 2022, në formën e një shoqërie të re aksionare të thjeshtuar sipas ligjit francez.

Më datë 05 tetor 2023, ndërmjet palëve Renault s.a.s dhe Volvo Business Services International AB është nënshkruar dokumenti “Marrëveshje Kuadër në lidhje me FlexEco”. Referuar kësaj marrëveshje, palët Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s do të nënshkruajnë dhe paguajnë Aksionet, të cilat do të emetohen nga ndërmarrja e përbashkët.

FlexEco SAS do të zotërohet 50% nga Volvo Business Services International AB dhe 50% nga Renault s.a.s.

Referuar shtojcës së Marrëveshjes Kuadër “Marrëveshje për Sipërmarrje të përbashkët”, çdo vendim, që do të duhet të merret nga Asambleja e Aksionarëve, do të kërkojë një kuorum pjesëmarrjeje prej të paktën 50% të kapitalit aksionar plus një aksion, si edhe shumicën e thjeshtë të votave të aksionarëve që marrin pjesë apo që janë përfaqësuar në mbledhje.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota (JV), nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s, me mjete të rritjes së kapitalit kundrejt nënshkrimit të aksioneve të reja.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit të automjeteve tregtare të lehta, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota (JV), nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s.

Volvo Business Services International AB është një shoqëri holding, e kontrolluar plotësisht nga AB Volvo, aktive në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e kamionëve, autobusëve, motorëve të makinave dhe makinerive të ndërtimit, si dhe shërbime financimi për klientët.

Grupi Volvo dhe Renault nuk kanë filiale të regjistruar në Shqipëri, por gjenerojnë xhiro nëpërmjet shitjeve të realizuara.

Renault s.a.s është një shoqëri aktive në prodhimin, tregtinë e automjeteve, të gjitha shërbimet e lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet shoqërive të tjera, administrimi i titujve (tituj pjesëmarrje dhe vendosjeje) dhe çdo veprimtari financiare, imobiliare apo tregtare lidhur me to.

FlexEco SAS është një shoqëri e cila do të fokusohet fillimisht në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e FlexE10, një LCV i mesëm.

Shoqëria e përbashkët nuk do të ketë asete në Shqipëri në momentin e themelimit të saj.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,


VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Volvo Business Services International AB dhe Renault s.a.s.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA

()
Zv/Kryetar


Rezana KONOMI

()
Anëtar

Adriana BERBERI

()
Anëtar

Durim KRAJA

()
Anëtar

Denar BIBA

()
Kryetar

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
AUTORITETI I KONKURRENCËS